



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Mbledhja nr. 13/2010

Prishtinë më 26.03. 2010, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Múfera Şinik, Kaqusha Jashari, Zef Morina dhe deputeti Bujar Dugolli.

Munguan: Fatmir Rexhepi, Sala Berisha – Shala, Murselj Halilji, Qamile Morina dhe Nerxhivane Dauti.

Pjesëmarrës të tjerë: Haxhi Gashi – USAID, Rrezarta Ahmetaj – KDI dhe Ibrahim Krasniqi - konsulent.

Stafi mbështetës: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Myzejene Selmani, kryetare.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d i t e

1. Rishqyrtimi i Propozim – Strategjisë së energjisë për prridhën 2009 – 2018.

Kryetarja - konstatoi se nuk ka kushte për të mbajtur mbledhjen sepse nuk ka kuorum të mjaftueshëm. Po ashtu njoftoi se Grupi punues më datë 23.03.2010, ka zhvilluar takim më përfaqësues të Bankës Botërore, dhe më datë 25.03.2010, takim më përfaqësueses të Ambasadës së SHBA-së dhe të KEK-ut. Ndërkaq për sot kemi ftuar MEM-in, MEF-in, MAPH, MPMS, ZRRE-në dhe Komitetin Drejtues të “Kosova e re”. Mirëpo, më keqardhje Ju njoftoi se asnjë nga këto institucione edhe përkundër ftesës nuk iu ka përgjigjur takimit të sotëm, përveç MEMit që ka kërkuar që të shtyhet takimi.

Zef Morina - meqenëse MEM-i ka propozuar që të shtyhet takimi, propozoj që të organizohet një mbledhje ditën e hënë.

Ethem Çeku – theksoi se nuk pajtohet që të organizohet një takim i ri të hënë pasi që Komisioni e ka caktuar mbledhjen e rregulltë për të martën. Po ashtu shprehu indinjatë për mos pjesëmarrjen e të ftuarve, po ashtu edhe të deputetëve të pozitës.

Kaqusha Jashari – kërkoi që të njoftohet më shkrim për takimet e grupit punues më institucionet e cekura më lartë.

Pas debatit Komisioni nxori këtë:

Përfundim

- *Për shkak të mungesës së kuorumit dhe të mos pjesëmarrësve të ftuar, mbledhja shtyhet për ditën e marte me 30.03.2010.*
- *Të njoftohet Kryetari i Kuvendit më rrjedhën e shqyrtimit të Strategjisë për energjinë 2009-2018.*

Mbledhja përfundoi në orën 13: 30.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani